



Shkolla Fillore

Shkolla fillore është e detyrueshme, zgjat 5 vjet (nga 6 deri në moshën 11 vjeç). Rregjistrimi dhe frekuentimi (i detyrueshëm) janë falas. Tekstet i jepen falas të gjithë nxënësve nga Bashkitë ;shkollat i dorëzojnë nxënësve kuponët e librave të nevojshëm për të tërhequr librat pranë librarive; ndërsa familjet duhet të blejnë fletoret, penat, ngjyrat dhe materjale të tjera të kerkuara nga mësuesit.

Listën e materjaleve do t'ja kërkonit mesuesve

* RREGJISTRIMI

Për të shkruar fëmijën në shkollë prindi duhet të plotësojë formularin që i jepet nga sekretarija. Në të duhet të autoçertifikoni datën e lindjes së nxënësit dhe të gjitha informacionet e tjera që kerkohen (sillni me vete pasaportën dhe lejen e qëndrimit).

Janë të nevojshëm dokumentat e mëposhtëm:

- ✓ **Dokumenti i identitetit të fëmijes** (Ne mungese të këtij dokumenti sillni me vete një dokument tuajin)
- ✓ **Dokumentet e shkolles që ka frekuentuar** (Në mungesë të këtyre dokumentave prindi deklaron nën përgjegjësinë e vet, klasën që ka frekuentuar në vendin e origjinës)

Në momentin e rregjistrimit plotësohen formularët për :

- ✓ Zgjedhjen e tipit të shkollës
- ✓ Nëse duan të përfitojnë për mësimin e fesë katolike ose jo

- ✓ *Rregjistrimi në menses e shkolles*
- ✓ *Rregjistrimi për hyrjen paraprake në shkolle ose dalje pas shkolle*
- ✓ *Rregjistrimin për transportin shkollor*

Për shpërndarjen dhe plotësimin e formularëve të menses, transportit, hyrjes paraprake dhe daljes mbas , ne disa raste interesohet shkolla drejtpersedrejt, në te tjera duhet t'i drejtoheni

Entit lokal: Komunes, Komunitetit të zonave malore.



* ORARI

Në shume shkolla prindërit mund të zgjedhin ndermjet dy mundësive:

✓ **klasa me “tempo pieno – kohë të plotë”:**

40 orë javore nga e hëna deri të premten mundesisht nga ora 8,30 deri në orën 16,30 (30 orë shkolle + 10 orë të mensës me asistencën e një mësuesi)

✓ **klasa me “tempo normale- kohë normale” ose MODULO:** nga e hëna deri të shtunën, 27 ose 30 orë javore. Orari javor (1 ose 2 pasdite) vendoset nga shkolla në veçanti. Nuk është e detyrueshme ngrënia në shkollë.

Mësimi fillon ndërmjet orës 08.00 dhe 8.30.

✓ **klasa me “tempo prolungato – kohë të zgjatur”:** parashikon kohën që i kushtohet mensës dhe rihyrjeve pasdite. Çdo shkollë organizon orarin mbi 5 o 6 ditë dhe ka orare të ndryshme

Është e rëndësishme të jeni të përpiktë si në hyrje ashtu edhe në dalje nga shkolla; vetëm një person në moshë madhore i autorizuar nga familja mund të marrë fëmijën nga shkolla.

Informohuni direkt mbi oraret e klasës së fëmijës tuaj

* KALENDARI SHKOLLOR

Shkolla zgjat rreth 9 muaj. Fillon në mes të shtatorit dhe mbaron në mes të qershorit.

Ka dy periudha pushimesh: dy javë për Krishtlindje (zakonisht nga 23 dhjetori deri me 6 janar)

Rreth një javë për Pashkë (në mars o prill).

Pastaj janë disa ditë pushimesh të ndara gjatë vitit.

Shkolla do t’ju informojë çdo herë me një lajmërim të shkruar në ditarin e fëmijës ose me një kalendar vjetor ku shënohen mbylljet për festa.

Prindërit do të njoftohen edhe për grevat o ndërprerje të tjera të mundshme të mësimin.

Është e rëndësishme të kontrolloni gjithmonë ditarin!

* MUNGESA NGA SHKOLLA

Çdo herë që fëmija nuk shkon në shkollë, prindi duhet të justifikojë motivin në ditarin shkollor



* **CFARË MËSOJNË FËMIJËT NË SHKOLLË**

Për sa i përket shkollës fillore, lëndët janë: italisht, anglisht, histori, gjeografi, matematikë, shkenca, teknologji e informatikë, muzikë, arte dhe vizatim, fiskulturë, mësimi i fesë katolike (sipas dëshirës).

* **MËSIMI I FESË KATOLIKE O ZGJEDHJE ALTERNATIVE**

Në shkollën italiane parashikohet mësimi fakultativ i fesë katolike. Në momentin e regjistrimit prindi mund të zgjedhë:

- ✓ Të përfitojë ose jo nga mësimi i fesë katolike
- ✓ Aktivitete didaktike dhe përgatitore në grup
- ✓ Dalje nga shkolla
- ✓ Aktivitete gjuhësore

* **SI VERËSOHEN REZULTATET SHKOLLORE**

Çdo vit shkollor ndahet në dy pjesë (2 katërmujorë). Në janar dhe qershor mësuesit bëjnë një vlerësim të rezultateve shkollore të fëmijës dhe përgatisin një "skedë vlerësimi - dëftesë" që do t'i dorëzohet familjes me gjykimin e shprehur në nota. Në bazë të rezultateve të arritura në fund të vitit nxënësi do të kalojë ose jo në vitin e mëtejshëm.

* **MBLEDHJET NDËRMJET PRINDËRVE DHE MËSUESVE**

Gjatë vitit shkollor organizohen disa mbledhje klase ndërmjet prindërve dhe mësuesve. Këto janë raste shumë të rëndësishme për të folur së bashku dhe për të njohur më mirë programin e studimit . Prindërit dhe mësuesit mund të bashkëpunojnë për edukimin e fëmijëve dhe hyrjen e tyre në shoqëri. Çdo klasë në fillim të vitit zgjedh një përfaqësues të prindërve me anë të votimit.

* **BASHKËBISEDIME**

Mësuesit në mënyrë periodike takojnë prindërit për të folur me ta mbi programin e klasës, mbi fëmijët, mbi vështirësitë dhe përparimin e tyre.

Çdo mësues njofton prindërit mbi ditën në të cilën mund t'i takojë për të folur.

Edhe prindërit mund të kërkojnë një bashkëbisedim me mësuesit; nëse kanë vështirësi me gjuhën mund të jetë prezent një mediator kultural

Nëse doni të flisni mbi fëmijën tuaj ,kërkoni menjëherë një takim me mësuesin/en



* SHËRBIME SIPAS KËRKESËS INDIVIDUALE

Shërbimet sipas kërkesës individuale janë : mensa, transporti e shërbimi i hyrjes paraprake dhe dalja më vonë.

Shërbimi i transportit dhe mensës drejtohen gjithmonë nga Bashkitë , por i kërkohet familjes të kontribuojë, me përjashtim të rasteve të veçanta.

Keni mundësi të merrni kontribute në pare nën formën e çekut ose të bursave të studimit për të blerë librat mësimor, aktivitete didaktike, udhëtime mësimore dhe lehtësime në pagimin e shërbimeve të transportit dhe të mensës. Është e nevojshme të plotësoni, zakonisht në muajin prill kërkesën që shpërndahet nga Komunitet /Shkollat e modelin ISEE për çertifikimin e të ardhurave dhe të mbani riçevutat fiskale për të dokumentuar shpenzimet e kryera.

Për pyetje të mundshme o për çfarëdo problemi drejtoheni sekretarisë së shkollës

Mensa (Dreka në shkollë)

Shërbimi i mensës është gati në të gjithë shkollat. Prindërit paguajnë për drekën një çmim që bazohet mbi të ardhurat familjare.

Është e mundur të kërkoni një dietë të veçantë , kërkesen duhet t'ja dorëzoni përgjegjësit të mensës per:

- ✓ motive shëndeti (është e nevojshme letra e mjekut)
- ✓ motive feje (është e nevojshme deklarata e prindërve)

Njoftoni në raste alergjije ose jo tolerime.

Për regjistrimin për ngrënien në shkollë duhet të plotësoni formularin e shtypur që ju dorëzohet nga Sekretarija e Bashkisë ose nga shkolla.

Për pyetje të mundshme o për çfarëdo problemi drejtoheni tek sekretarija e shkollës.

Transporti

Është e mundur të kërkoni transportin shkolor me autobus duke paguar një çmim vjetor.

Hyrja paraprake – dalja mbrapa

Për të ndihmuar familjet që kanë orare pune të veçanta , (fillojnë herët o mbarojnë vonë punën), disa shkolla organizojnë aktivitete PARA-SHKOLLES (nga ora 7,30 deri në orën 8,30) dhe PAS-SHKOLLE(nga ora 16,30 e pas).

Në përgjithësi është e mjaftueshme të paraqitni një deklaratë nga punëdhënësi.

Pyetni në shkollë nëse shërbimi është i disponueshëm dhe në çfarë orarësh